

**Prishtinë, 13 qershor 2006**

## KOMUNIKAËT PËR SHTYP

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë njofton opinionin e gjerë se shqyrtimi i çmimeve dhe tarifave të energjisë elektrike ka filluar në fillim të Marsit 2006. Duhet cekur se ky është shqyrtimi i parë i çmimeve në sektorin e energjisë elektrike që udhëhiqet nga ZRrE-ja, bazuar dhe në përputhje me Rregullin e përcaktimit të çmimeve dhe metodologjinë e tarifave.

Shqyrtimi i çmimeve nënkupton procesin e verifikimit dhe të shpenzimeve të ndërmarrjeve energjetike, llogaritjes dhe përcaktimit të tarifave bazuar në mbulimin e shpenzimeve reale dhe te arsyeshme që i shkakton ndërmarrja energjetike për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me energji elektrike. Gjithashtu vëmendje dhe kujdes i veçantë i kushtohet mbrojtjes së konsumatorëve gjithnjë duke marr parasysh Çmimin e Indeksit të Konsumit dhe Inflacionin. Këto dy qasje paraqesin një balancim në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe ndërmarrjeve energjetike.

Plani i zbatimit dhe orari i përcaktuar për shqyrtimin e tarifave për sektorin e energjisë elektrike paraqet një proces ku janë cekur obligimet dhe detyrat e ndërmarrjeve energjetike dhe të ZRRE-së. Ndër të tjera gjatë muajit shtator Bordi i ZRRE-së do të vendos për shpenzimet e lejuara dhe strukturën tarifore duke përfshi edhe tarifën për kategoritë e konsumatorëve. Tarifën e rregulluar për çdo kategori konsumatorësh do të jenë uniforme në të gjithë Kosovën.

Sipas këtij orari pritët që tarifën e reja të aprovohen në fund të dhjetorit dhe do të hyjnë në fuqi me 1 Janar 2007.

Ndër përgjegjësitë e ZRrE-së poashtu është edhe përcaktimi dhe aprovimi i tarifave të ngrohjes qendrore. Gjithashtu bazë e llogaritjes dhe përcaktimit të tarifave në sektorin e ngrohjes qendrore, siç është përcaktuar në legjislacionin përkatës sekondar dhe metodologjinë tarifore, është mbulimi i shpenzimeve reale dhe të arsyeshme të ngrohësve dhe mbrojtja e konsumatorëve.

Tani është viti i tretë që bë bëhet shqyrtimi i çmimeve për këto tarifa, ku p.sh në rastin e Termokosit, për dy sezonet e ngrohjes 2004/2005 dhe 2005/2006, tarifën e aprovuar për kategoritë e konsumatorëve shënojnë mesatarisht zbritje rreth 20%.

Shqyrtimi i çmimeve për sezonin e ardhshëm, 2006/2007 është në vijim, dhe pritët që tarifën e reja të aprovohen gjer në fillimin e sezonit në fjalë – 15 Tetor 2006.